



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

V E N D I M

Nr. 74 , Datë 28/06/2013

Bazuar në pikën 11, të nenit 33, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi:

KONSTATON:

Mbështetur në nenin 32, pika 1, germat "a" dhe "c", dhe pika 3 e këtij neni, nenit 33, pika 10 të ligjit nr. 10221/2010 "*Për mbrojtjen nga diskriminimi*", Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka ndjekur të gjithë hapat që parashikon procedura e hetimit, për të shqyrtuar ankesën nr. 20, datë 29.03.2013, që Ambasada Pink dhe organizata Pro LGBT Shqipëri kanë paraqitur pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, kundër z. [Blank], për diskriminim për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor.

Bazuar në ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*" në fund të procedurës së hetimit ka dalë Vendimi nr. 58, datë 08.05.2013, me anë të të cilit është vendosur se: "Shprehjet e përdorura nga z. [Blank] në artikullin e datës 23.03.2013 me titull "*Dështimet e Shtetit*" të publikuar në gazetën "*Shqip*", janë diskriminuese, pasi ato paragjykojnë dinjitetin dhe cenojnë sigurinë dhe mbrojtjen nga dhuna të personave për shkak të orientimit seksual". Në paragrafin e dytë të këtij vendimi Komisioneri ka rekomanduar: "Detyrimin e z./ [Blank] të kërkojë publikisht ndjesë brenda 15 ditëve, nga marrja dijani për këtë vendim, dhe të evitojë në të ardhmen përdorimin e gjuhës e cila prodhon efektin e përhapjes, nxitjen e urrejtjes apo të tjera forma të diskriminimit kundër personave për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor të tyre". Palët e interesuara kanë marrë dijani për vendimin.

Bazuar në pikën 11, të nenit 33, të ligjit nr. 10221/2010 "*Për mbrojtjen nga diskriminimi*", si dhe në pikën 3, të Vendimit nr. 58, datë 08.05.2013 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, z.A [Blank], duhet të raportonte, brenda 30 ditëve, para Komisionerit për veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi duke bërë me dije Komisionerin për masat e marra.

Me shkresën datë 20.05.2013, të z. _____ e, i drejtohet Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, por nga përmbajtja e shkresës, nuk raportohet asnjë veprim i ndërmarrë për të zbatuar vendimin nr. 58, datë 08.05.2013 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Me shkresën nr.250/2 prot, datë 05.06.2013, Komisioneri në mes të tjerash i rikujton dhe njëherë z./ _____ e të përmbushë në afat Vendimin nr. 58, datë 08.05.2013.

Sa më sipër Komisioneri arrin në konkluzionin se z. _____ është në shkelje të parashikimeve të bëra në pikën 11, të nenit 33, të ligjit nr. 10221/2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", pasi nuk ka zbatuar vendimin nr. 58, datë 08.05.2013 të Komisionerit.

PËR KËTË ARSYE :

Bazuar në nenin 32, pika 1, germa "ç", nenin 33, pikat 11,12,13/a e 14 të ligjit nr. 10221/2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

VENDOSI:

1. Z. A _____ gjobitet me gjobë në vlerën 10.000 (dhjetë mijë) lekë.
2. Gjoha të derdhet në Buxhetin e Shtetit brenda datës 02 Gusht 2013.
3. Zbatimi i vendimit nr. 58 datë 08.05.2013 i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi brenda shtatë ditëve nga marrja dijeni për sanksionet, sjell shfuqizimin e tyre.
4. Subjekti z. _____ e, duhet të njoftojë Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi në përputhje me sa parashikohet në pikën 3, të këtij vendimi.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim sipas ligjit.

[Faint handwritten signature or mark]

